



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.6.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha Udhëheqës Ekipi dhe Fanol Hodolli, Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	29
Shtojca III: Letër konfirmimi	37

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Pejës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Pejës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Pejës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për

kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive;

- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Plani fillestar dhe final i prokurimit;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të ZKA-së dhe auditimit të brendshëm në Kuvendin Komunal; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për thesarin, përfshirë Pasqyrat Nëntëmujore.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash përfshirë të hyrat dhe shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime, ku në disa raste nuk janë duke u zbatuar kërkesat ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit, planifikimi dhe realizimi i buxhetit, si dhe raportimi dhe pagesa e obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	22,464,703	24,225,407	23,082,882	22,047,434	21,146,160
Granti i Qeverisë -Buxheti	18,035,657	18,060,254	18,027,839	17,496,799	17,984,147
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	1,084,335	1,060,824	728,484	648,492
Të hyrat vetjake ³	4,429,046	4,429,046	3,384,644	2,841,727	2,217,268
Donacionet e brendshme	0	229,905	194,279	472,244	50,640
Donacionet e jashtme	0	421,867	415,296	508,180	245,613

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

² Të hyrat vetjake të komunës të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,760,704€ apo 8%. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme prej 651,772€, vendimit të qeverisë prej 24,597€, si dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 1,084,335€.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 23,082,882€, me një përmirësim prej 1% krahasuar me vitin 2016 (94%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	22,464,703	24,225,407	23,082,882	22,047,434	21,146,160
Pagat dhe Mëditjet	13,194,668	13,252,684	13,219,353	13,213,466	13,002,566
Mallrat dhe Shërbimet	2,447,947	2,480,024	2,407,120	2,559,607	2,262,418
Shërbimet komunale	701,924	709,111	683,863	664,499	606,154
Subvencionet dhe Transferet	300,000	309,058	286,808	248,570	359,212
Investimet Kapitale	5,820,164	7,474,530	6,485,738	5,361,292	4,915,810

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit final për paga dhe mëditje për 58,016€ në krahasim me buxhetin fillestar është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 17,393€, donacioneve në vlerë 16,026€ si dhe vendimit të qeverisë në vlerë 24,597€. Realizmi i buxhetit në këtë kategori është 99.7%;
- Rritja e buxhetit final për mallra dhe shërbime për 32,077€ në krahasim me buxhetin fillestar është rezultat i rritjes nga të hyrat e bartura prej 29,563€, si dhe donacioneve në vlerë 2,514€. Ndërsa rritja e buxhetit për shpenzime komunale në vlerë 7,187€ është rezultat i të hyrave të bartura. Realizmi i buxhetit për mallra dhe shërbime është 97%, ndërsa tek komunalit 96%;
- Po ashtu rritja e buxhetit final për subvencione dhe transfere për 9,058€ është rezultat i të hyrave të bartura, derisa realizmi i buxhetit në këtë kategori ishte 93%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar është rritur për 1,654,366€. Rritja është si rezultat i të hyrave të bartura prej 1,021,134€, si dhe grandeve të përcaktuara të donatorëve prej 633,232€. Realizmi i buxhetit në këtë kategori ishte 87%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Pejës në 2017 janë në vlerë 3,051,922€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 ⁴ Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,429,046	4,429,046	3,051,922	3,016,853	2,915,694
Totali	4,429,046	4,429,046	3,051,922	3,016,853	2,915,694

Tatimi në pronë i faturuar gjatë vitit 2017 ishte 2,009,033€, prej tyre janë arkëtuar 777,183€ apo 39%. Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë Komuna e Pejës kishte edhe të hyra indirekte nga dënimet në trafik dhe gjobat në vlerë 534,275€.

Çështja 1 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

- E gjetura** Komuna nuk ka bërë verifikimin e 1/3-ës të pronave, sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2011 nenit 13. Nga 39,563 prona të evidentuara në bazën e të dhënave mbi tatimin në pronë, komuna ka arrit të verifikoj vetëm 203 prona aktuale të regjistruara, ose vetëm 0.51%.
- Rreziku** Verifikimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale, dhe ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë, që janë regjistruar me gabime në bazën tatimore dhe nuk janë azhurnuar. E gjithë kjo ndikon në normën reale të mbledhjes së tatimit në pronë.
- Rekomandimi 1** Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave të paluajtshme për tatimit në pronë duhet të bëhet sipas rregullave, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese me qëllim të përcaktimit të taksave sipas barrës reale për të gjitha objektet në territorin e komunës.

⁴ Pranimet për vitin 2016/2015 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

Çështja 2 -Mos aplikimi i cilësisë së objekteve në vlerësimin dhe tatimin në pronë

- E gjetura** Zyra Komunale e Tatimit në Pronë nuk ka marrë parasysh cilësinë e objekteve me rastin e kalkulimit të ngarkesës tatimore. Në bazë të UA nr.03/2011 mbi mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesit duhet të klasifikohet gjendja e objekteve sipas faktorit të cilësisë së ndërtimit e shprehur në koeficient, e cila varësisht prej gjendjes së objektit (shumë e dobët, e dobët, mesatare, e mirë dhe e shkëlqyeshme) rritë apo e zvogëlon ngarkesën tatimore). Sipas zyrtarëve të tatimit në pronë aplikimi i cilësisë së objekteve do të filloj në vitin 2018.
- Rreziku** Mos klasifikimi i gjendjes së objekteve mund të ndikojë që ngarkesa tatimore të mos jetë në përputhje me gjendjen reale të pronës ku si rezultat tatimpaguesit të cilët kanë cilësi më të dobët të pronës të mbingarkohen me tatime, apo tatimpaguesit me cilësi më të mirë të pronës të ngarkohen më pak se sa duhet. Kjo gjithashtu mund të ketë ndikim në të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë.
- Rekomandimi 2** Kryetari i komunës duhet të siguroar se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për kalkulimin e drejtë të ngarkesave tatimore ndaj taksapaguesit duke aplikuar kriterin e cilësisë së objekteve në përputhjeje me koeficienteve e përcaktuar nga ligjvënësi.

Çështja 3 - Menaxhim jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira

- E gjetura** Sipas Ligjit 041/144, dhënia e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim bëhet përmes konkurrencës së hapur publike. Komuna, në vitet paraprake ka dhënë me qira 25 objekte komunale për shfrytëzim të përkohshëm. Megjithatë gjatë testeve tona identifikua se në katër raste mungonin kontratat dhe dokumentacioni për shfrytëzim të objekteve, ndërsa në tri raste tjera, kontratatave u kishte kaluar afati. Për këto raste komuna nuk kishte zhvilluar procedurat për dhënie e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër, realizohen përmes konkurrencës së hapur publike.
- Rreziku** Dobësitë e identifikuar mund të rezultojnë me konkurrencë të limituar apo me më pak të hyra nga kjo kategori dhe trajtim jo të barabartë të palëve me rastin e përcaktimit vullnetar (paushall) të çmimeve. Gjithashtu edhe operimi me kontrata të skaduar privon komunën nga e drejta për arkëtimin e të hyrave dhe ndjekjen e proceduarve gjyqësore në raste të mos inkasimit të të arkëtueshmeve me kohë.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të analizoj arsyet për menaxhimin jo të duhur të pronës komunale dhe siguroj se dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale të bëhet vetëm atëherë kur janë plotësuar kërkesat ligjore konform rregullave.

3.3 Pagat dhe shtesat

Komuna ka arrit ta shfrytëzoj 99.7% të buxhetit final për paga dhe shtesa të cilat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Kontrollat kyçe që aplikon komuna janë monitorimi dhe nënshkrimi i listave të pagave nga zyrtaret kompetent.

Çështja 4 - Mos respektimi i kriterëve të konkursit publik

- E gjetura** Në dy rastet në vijim kemi vërejtur se kriteret e konkursit publik nuk janë respektuar me rastin e punësimit të mësimdhënësve. Te konkursi Nr.04/01 i datës 05/01/2017 për pozitën “Mësues/e klase” kandidati i përzgjedhur nuk kishte dokumentuar përvojën e punës. Po ashtu për pozitën “Mësimdhënës nga lënda e biologjisë” kandidati i përzgjedhur nuk kishte dokumentuar trajnimet arsimore në përputhje me kriteret e kërkuara sipas konkursit.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të konkursit publik me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për mësimdhënës rrit rrezikun e punësimit të mësimdhënësve jo kompetent. Për më tepër, kjo mund të shkaktojë diskriminim të kandidatëve të tjerë dhe ta dëmtojë cilësinë e arsimit në shkolla.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet t’i forcojë kontrollet e burimeve njerëzore dhe të sigurojë se me rastin e rekrutimit të stafit të arsimit do të respektohen kriteret e konkursit publik dhe do të pranohen vetëm kandidatët që plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara.

Çështja 5 - Mos azhurnimi i dosjeve të personelit arsimor

- E gjetura** Gjatë auditimit kemi vërejtur se në Drejtorinë e Arsimit në shtatë raste dosjet e personelit arsimor ishin të pakompletuara. Në një rast mungonte diploma e të punësuarit, në dy raste vërtetimet e përvojës së punës, dhe në disa raste tjera dokumentet personale dhe vendimet për pushime.
- Rreziku** Mos azhurnimi i dosjeve dhe mos kompletimi me dokumentacionin e nevojshëm rrit rrezikun që menaxhmenti të mos ketë informata të plota lidhur me stafin e punësuar që ndikon në menaxhim jo adekuat të stafit.
- Rekomandimi 5** Kryetari i duhet të sigurojë se të gjitha dosjet e të punësuarve do të kompletohen me dokumentacionin e nevojshëm me qëllim të menaxhimit të stafit dhe matjes së performancës, arritjes së objektivave e cila duhet të rregullohet edhe me një politik specifike të brendshëm për këtë çështje.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe shpenzime komunale në vitin 2017 ishte 3,189,135€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,090,983€ apo 97% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me pagesat për komunal, udhëtime, telekomunikim, shërbime, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje e të tjera.

Komuna kishte planifikuar 15 aktivitete të prokurimit, mirëpo kishte tejkalluar dukshëm këtë numër në 22 aktivitete të realizuara. Në të gjitha mostrat e testuara ishin caktuar menaxherët e kontratave dhe punët e kryera janë konfirmuar para çdo pagese. Megjithëse ne identifikuam parregullsi në aktivitetet tjera, si:

Çështja 6 – Dobësi në angazhimin e stafit sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta

E gjetura Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12 pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Komuna ka angazhuar 49 zyrtarë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, ku janë identifikuar dobësi si në vijim:

- Në 24 raste periudha e angazhimit të zyrtareve është më i gjatë se sa afati i përcaktuar me rregulla, mbi gjashtë muaj;
- Në 28 raste komuna nuk ka zbatuar ndonjë procedurë të rekrutimit konform kërkesave ligjore; dhe

Rreziku Dobësitë e identifikuara mund të rezultojnë me mungesë të mirëfilltë të konkurrencës dhe cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara. Në mungesë të kontrolleve komuna rrezikon rritje të pa planifikuar të këtyre shpenzimeve që mund të ndikojnë në mos realizimin e objektivave tjera të përcaktuara.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rast se ka nevojë për të punësuar shtesë në komunë (pozita të rregullta) të sigurojnë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje përfshihen pagat e të gjithë të punësuarve të nevojshëm, si dhe të gjitha pagesat për pagat e tyre të kalojnë përmes sistemit të pagave.

Çështja 7 - Mangësi në përgatitjen e paramasës dhe parallogarisë

E gjetura Tek aktiviteti i prokurimit “Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje në pronat private dhe publike” në Komunën e Pejës, kemi identifikuar dobësitë në vijim:

Paramasa dhe parallogaria nuk ishte përgatitur nga njësia kërkuese, por si dokument vetëm ishte nënshkruar nga një zyrtar i kësaj njësie, pa kontribuar në një analizë të mirëfilltë të përcaktimit të masës apo llogaritjes të kërkesës për tenderimin e këtij shërbimi. Bazuar në rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimit publik para inicimit të procedurës së prokurimit duhet përgatitur përmasa dhe parallogaria nga njësia kërkuese për projektin e caktuar.

Po ashtu përllogaritja e vlerës së kontratës duhet të bëhet bazuar në çmimet e tregut, çmimet e publikuara nga zyra e statistikave apo çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga autoriteti i njëjtë apo tjetër kontraktues. Megjithatë komuna nuk ka marrë për bazë çmimet e kontratës paraprake me rastin e parashikimit të vlerës së kontratës ku në dy pozicionet dominante çmimet ishin rritur mbi 100% pa ndonjë arsytim.

Rreziku Mos përgatitja e paramasës dhe parallogarisë nga njësia kërkuese është në kundërshtim me LPP-në dhe njëherësh rrit rrezikun që lloji, dhe sasia e punëve apo furnizimeve të kontraktuara të mos jetë në përputhje me nevojat reale të institucionit, si dhe çmimet të mos jenë në përputhje me çmimet e tregut.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme të cilat sigurojnë se paramasa dhe parallogaria përgatiten nga njësia kërkuese në mënyrë që furnizimet të jenë në përputhje me nevojat reale të institucionit, dhe se përllogaritja e vlerës së kontratës do të bëhet në pajtim me kërkesat e LPP-së.

Çështja 8 – Mos respektimi i parimeve për ndarjen e detyrave sipas ligjit të prokurimit

E gjetura Sipas Rregullës të udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik 2016 neni 62.3.- parimet e ndarjes së detyrave, një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet teknike ose ka përcaktuar standardet e cilësisë nuk mund të marrë pjesë si anëtarë i komisionit të vlerësimit. Megjithatë, auditimi ynë ka identifikuar tek aktiviteti i prokurimit “Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje në pronat private dhe publike” në Komunën e Pejës zyrtari i njëjtë i cili ka përgatitur specifikimet teknike ishte caktuar kryetar i komisionit të vlerësimit duke anashkaluar parimet për ndarjen e detyrave.

Rreziku Mosrespektimi i parimeve për ndarjen e detyrave është në kundërshtim me legjislacionin përkatës të prokurimit dhe rrit rrezikun për paraqitjen e konfliktit të interesit dhe/apo vlerësim jo-objektiv të tenderëve.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojnë se me rastin e formimit të komisioneve të ndryshme do të respektohen parimet për ndarjen e detyrave siç parashihet me ligjin në fuqi.

Çështja 9 – Vendosja e kriterëve të paqarta tek aktiviteti i prokurimit

- E gjetura** Te aktivitetit i prokurimit “Furnizimi me dru për ngrohje”, te kontrata në vlerë 115,911€ e datës 23/11/2017, kemi vërejtur se në dosje të tenderit tek specifikimet teknike nuk ishte specifikuar lloji i drurit për furnizim. Megjithatë, tek përshkrimi i llojit të drurit ishin vendosur disa lloje të drurit (dru dushku, bungu, qarri ose ahu) për të cilat Operatorit Ekonomik (OE) duhej të ofronin një çmim të vetëm për m³. Kjo kishte ndodhur për shkak se specifikimet teknike ishin marrë nga kontrata paraprake.
- Rreziku** Meqenëse, çmimet dallojnë varësisht nga lloji i caktuar i drurit, mos përcaktimi i qartë i llojit të drurit për të cilin OE duhet të ofrojnë ofertat e tyre shkakton paqartësi tek OE se për cilin lloj të drurit duhet të ofrojnë çmimet e tyre. Kjo mund të ndikojë që çmimet e ofruara nga operatorët të jenë më të larta, pasi që OE mund të ofrojnë çmime për llojin e drurit i cili është më i shtrenjtë përderisa furnizimi bëhet me dru ahu të cilat kanë çmimin më të ulët.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë që në raste të tilla të specifikohet qartë lloji i drurit me të cilin do të furnizohet komuna në përputhje me nevojat reale.

Çështja 10 - Pagesa pa dëshmi të mjaftueshme

- E gjetura** Në dosjen e pagesës të datës 27/04/2017 në vlerë 6,441€ për shërbime të transportit kemi vërejtur se në kuadër të kësaj pagese fatura në vlerë 1,968€ ishte për pjesëmarrjen e drejtorëve të shkollave dhe profesorëve në seminarin e organizuar në Vlorë, megjithatë nuk kishte ndonjë kërkesë të aprovuar apo listë të stafit që kishte marrë pjesë në këtë seminar.
- Rreziku** Pagesa pa siguruar dëshmi të mjaftueshme siç janë kërkesa e aprovuar për udhëtim dhe lista e pjesëmarrësve mund të rezultojë me shpenzime të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e udhëtimeve paraprakisht do të aprovohet lista e pjesëmarrësve për të siguruar që shpenzimet do të bazohen në dëshmi adekuate dhe të mjaftueshme.

Çështja 11 - Vazhdimi i kontratës publike kornizë në kundërshtim me LPP-në

- E gjetura** Sipas nenit 38, të LPP-së, kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet. Megjithatë, kontrata publike kornizë për “Furnizim me naftë dhe derivate të naftës “ e cila kishte skaduar me datën 01/11/2017, ishte vazhduar me datën 03/11/2017 edhe për dy muaj shtesë, për shkak se procedurat e prokurimit për furnizim me derivate pritet të zhvillohen nga AQP-ja.
- Rreziku** Vazhdimi e kontratave publike kornizë është në kundërshtim me LPP-në dhe mund të rezultojë me vlerë të shërbimit të ofruara jo konform çmimeve të tregut.
- Rekomandimi 11** Kryetari të sigurohet se janë duke u zbatuar kërkesat ligjore të prokurimit tërësisht dhe nuk do të praktikohet në asnjë rast të vetëm vazhdimi i kontratave publike kornizë, kërkesë e LPP-së.

Çështja 12 - Mangësi në formimin e komisionit për pranimin e furnizimeve me dru për ngrohje.

- E gjetura** Te kontrata kornizë për “Furnizim me dru për ngrohje të shkollave dhe institucioneve shëndetësore” e nënshkruar me 12/11/2014, me vendim të Kryetarit, ishte formuar komisioni për pranimin e furnizimeve i përbërë nga tre anëtarë. Megjithatë në këtë komision nuk ishte angazhuar asnjë zyrtar nga shkollat apo institucionet ku është bërë furnizimi me dru, prandaj institucionet e furnizuara nuk posedojnë fletëdërgesa apo ndonjë dëshmi që vërteton sasinë e druve të pranuar gjatë sezonit 2016/2017 në këto institucione.
- E gjetura** Mos pjesëmarrja në komisionin për pranimin e furnizimeve të institucioneve që furnizohen rezulton në mungesë të informatave rreth sasisë reale të furnizimeve dhe shpenzimet për këto furnizime mund të jenë potencialisht të parregullta.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë se në pranimin e furnizimeve përfshihet edhe stafi i institucioneve relevante për të siguruar dëshmi dhe informata mbi sasinë e furnizimeve të kryera.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 309,058€. Prej tyre në 2017 janë shpenzuar 286,808€ apo 93% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

Çështja 13 – Mos raportimi nga përfituesit e subvencione për mënyrën e shfrytëzimit.

E gjetura Në dy raste përfituesit e subvencioneve në vlerë totale 25,000€, nuk kishin përgatitur raporte financiare dhe raportet narrative, të cilat do të dëshmonin se subvencioni është shfrytëzuar për qëllimin e dhënë. Përfituesit kishin ofruar vetëm disa fatura dhe dëshmi të transfereve bankare në të cilat vërehej se mjetet ishin shpenzuar për qëllime tjera në raport me qëllimin për të cilin janë dhënë. Rregullorja Komunale (K.PE) Nr.01/2017 për subvencione, përcakton që përfituesi i subvencionit duhet të dorëzojnë raportet financiare dhe narrative me dëshmitë e dokumentuara si kërkohet në projekt propozim.

Rreziku Mos raportimi i përfituesve të subvencioneve lidhur me realizimin e projekteve të subvencionuara dhe shfrytëzimi i mjeteve për qëllime tjera ndikon në mos arritjen e objektivave të përcaktuara dhe si rrjedhojë ndikon në dëmtimin e buxhetit.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e subvencioneve raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, dhe në rastet kur mjetet nuk shfrytëzohen për qëllimin e dhënë të ndërmerren masa ligjore ndaj përfituesve të subvencioneve.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,474,530€. Prej tyre në 2017 komuna ka shpenzuar 6,485,738€. Ato kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës, ndërtimin e objekteve, asfaltimin e rrugëve, kanalizim pajisje, betonim të kanaleve të ujitjes, përmirësime të ndryshme të kapitalit e të tjera.

Komuna kishte planifikuar 21 aktivitete të prokurimit, mirëpo kishte realizuar 95 aktivitete, ose 74 më shumë në raport me planifikimin. Diferenca rrjedh sepse aktivitetet të cilat janë financiar nga organizatat tjera buxhetore nuk kanë qenë të planifikuara po ashtu projektet e planifikuara kanë qenë të përgjithësuara. Në të gjitha rastet komuna kishte konfirmuar punën e kryer para çdo pagese, po ashtu për secilën kontratë ishte caktuar menaxheri i kontratës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 14 - Pagesat me vendime gjyqësore

E gjetura Komuna gjatë vitit 2017 sipas vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë ekzekutuar pagesa prej 606,990€. Me këtë rast komuna ka paguar 60,576€ si shpenzime shtesë për procedurë përmbartimore, interes, taksa etj. Shkaku i këtyre pagesave ishin kryesisht vonesat në shlyerjen e obligimeve, dhe shqyrtimi jo i duhur i kontesteve të ndryshme.

Rreziku Numri i madh i pagesave të bazuara në vendimeve gjyqësore ndikojnë në dëmtimin e buxhetit për shkak të paraqitjes së shpenzimeve përmbartimore, interesit, taksat, etj.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të një numri mjaft të madhe të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminimin e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrimit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 321,690,088€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 222,037€. Çështjet e ngritura në memorandumin e auditimit të ndërmjetëm ishin adresuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.9 Të arkëtueshmet

Komuna e Pejës ka prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë totale 16,282,160€ që kanë të bëjnë me: tatimin në pronë 9,415,514€, ngarkesa për afarizëm të bizneseve 6,393,359€, qiraja komunale me karakter të përkohshëm në vlerë 32,540€, çerdhja 1,897€, kërkesat nga parkingu 27,000€, si dhe kërkesat nga paditë **gjyqësore 411,850€**.

Çështja 15 – Mangësi në trajtimin e llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Llogaritë e arkëtueshme të Komunës së Pejës krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 696,000€. Megjithatë, komuna nuk kishte ndonjë plan dhe nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për arkëtimin e tyre.
- Rreziku** Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mbeten sfidë edhe për periudhën e ardhshme. Mos inkasimi i të arkëtueshmeve rrezikon që ato vjetërsohen dhe të bëhen të pambledhshme duke krijuar një humbje të drejtpërdrejtë financiare për Komunën.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 është prezantuar 1,585,892€. Krahasuar me vitin paraprak obligimet janë rritur për 928,420€ apo 141%, ku vlera e obligimeve në fund të vitit 2016 ishte 657,472€. Këto janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Mos pagesa e obligimeve kryesisht ka ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit.

Çështja 16 – Vonesa në pagesën e faturave dhe mos raportim i obligimeve

- E gjetura** Komuna në 19 raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 266,948€ i kishte paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh, kërkesë e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, neni 39, që obligon komunën për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit.
- Gjithashtu në pesë raste faturat/obligimet ndaj furnitorëve në vlerë 23,801€ nuk ishin përfshirë në raportet mujore të obligimeve, kërkesë e Rregullores Nr. 02/2013, që obligon komunën të raportoj në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara.
- Rreziku** Kontrollat jo të mira në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve rrisin rrezikun e hyrjes në obligime pa mbulesë buxhetore apo përballje me drejtësinë duke krijuar edhe shpenzime shtesë dhe vështirësi buxhetore për vitet pasuese.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.
-

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të Komunës së Pejës ka rezultuar me 19 rekomandime kryesore. Komuna e Pejës kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Megjithatë, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme pasi që plani i veprimit nuk është zbatuar në tërësi dhe mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në disa fusha.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, nëntë rekomandime janë zbatuar plotësisht, katër ishin në proces të zbatimit, ndërsa gjashtë nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 14 rekomandime, dhe në vitin 2017, nga të cilat pesë ishin zbatuar, gjashtë të tjera ishin në zbatim e sipër dhe tri nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 17 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura Megjithëse, komuna ka hartuar me kohë planin e veprimit, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Menaxhmenti i komunës nuk aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të ndikojë në dobësi në menaxhim dhe raportim të shpenzimeve.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore apo tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna e Pejës gjatë vitit 2017 ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje siç është hartimi i regjistrit të rreziqeve, megjithatë ende mbesin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme. Auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive si: raportimi i dobët menaxherial, monitorim jo adekuat në zbatimin e plotë të rekomandimeve të ZKA-së, si dhe mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Komuna e Pejës, kishte hartuar strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal, planet urbanistike, planin operativ emergjent si dhe planin strategjik kundër korrupsionit.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit, njeri i emëruar si drejtor. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit. Krahas Planit strategjik, NjAB kishte hartuar Planin vjetor të punës për vitin 2017 ku kishte planifikuar kryerjen e dhjetë auditimeve të cilat ishin realizuar në tersi gjatë vitit. Menaxhmenti kishte përgatitur planet për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-it dhe kishte zbatuar pjesën më të madhe të tyre.

Çështja 18 - Funksionimi i kufizuar i Komitetit të Auditimit

- E gjetura** Ndonëse Komuna e Pejës e ka themeluar Komitetin e Auditimit, ky i fundit nuk kishte mbajtur asnjë takim gjatë vitit 2017 dhe si i tillë nuk ishte funksional. Megjithatë në fund të vitit 2017 komuna kishte formuar Komitetin e ri të auditimit.
- Rreziku** Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit redukton aftësinë e mbikëqyrjes së aktiviteteve të NjAB-së dhe fuqizimin e mëtejshëm të rolit të auditimit të brendshëm.
- Rekomandimi 18** Kryetari duhet të sigurojë një funksionim efektiv dhe të plotë të Komitetit të Auditimit për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e NjAB-së.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 19 - Dobësi në kontrollet menaxheriale

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Format i aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore. Si pasojë e kontrolleve jo të mira janë vërejtur dobësi në fushën e të hyrave, prokurimit, subvencioneve, pagesën e shpenzimeve, si dhe në raportimin e obligimeve.

Komuna e Pejës kishte hartuar një regjistër të rreziqeve ku ishte bërë identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme. Megjithatë, nuk kishte monitoruar formalisht menaxhimi i tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të monitorojë menaxhimin e rreziqeve dhe të ndërmerre veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.5 Rekomandimet për PVF	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për ti adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve jo-kapitale, dhe për të siguruar regjistrimin dhe vlerësimin e saktë të pasurive kapitale.	Po		
1.5 Rekomandimet	Kryetari duhet të sigurojë se ZKF raporton në mënyrë sistematike mbi progresin e fizik dhe financiar të investimeve kapitale. Aty ku është e nevojshme, duhet të azhurnohen projektet në programin e investimeve kapitale, në mënyrë që kërkesat e ardhshme buxhetore të jenë bërë në bazë të nevojave reale për investime.	Po		
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike zbatimin e planit të veprimit dhe të identifikoj arsyet pse i njëjti nuk është zbatuar. Një plan i rishikuar duhet të përcaktoj saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.			Nuk janë marrë masa.

2.4. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Një rol ndihmës në ngritjen e cilësisë dhe konfirmimit të pohimeve në pyetësorin e vetëvlerësimit, mund të ofroj auditimi i brendshëm përmes rishikimit përfundimtar.		Nuk janë ndërmarrë veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në pyetësorin e vetëvlerësimit.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se pas hartimit të një liste të rreziqeve me nivelet përkatëse, përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut është deleguar tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi mbarëvajtjen e procesit.		Është hartuar regjistri i rreziqeve, por nuk është monitoruar mbarëvajtja e procesit të menaxhimit të rreziqeve.	
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura mbi drejtoritë e komunës dhe të implementojë aranzhime më të mira për arritjen e objektivave të specifikuar dhe për të përmirësuar qeverisjen e mirë në të gjithë komunën.			Nuk janë marrë masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë nevojën që planet e auditimit të brendshëm të përshtaten me kërkesat që auditimi i brendshëm të ndjekë aktivitetet gjatë vitit aktual dhe të propozoj masa të menjëhershme përmirësimi. Gjithashtu, komiteti i auditimit duhet të jetë shumë më aktiv në mbikëqyrjen, ngritjen dhe fuqizimin e rolit të auditimit të brendshëm.		NjAB ka arritur të realizoj planin në tërësi, mirëpo Komiteti i auditimit nuk ishte funksional gjatë vitit 2017.	

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku mund të bëhen përshtatjet për reduktim të shpenzimeve operative, të njëjtat të rishikohen për koncentrim në projekte kapitale.	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet e çertifikimit do të forcohen, dhe se pas konfirmimit se të gjitha furnizimet janë kryer përmes raporteve të qarta të pranimi dhe në pajtim me kushtet e kontratave, mund të procedohet me pagesa. Në të kundërtën, pagesat nuk duhet të çertifikohen.	Po		
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të vendosë kritere të qarta lidhur me përfitimin/refuzimin e kërkesave për subvencione. Të sigurohet që me rastin e subvencioneve të lejuara të kërkojnë që të përpilohen raporte përshkruese bashkangjitur me dëshmi dhe fatura për arsyeshmërinë e shpenzimeve dhe të përcillen aktivitetet për të cilat është lejuar subvencioni.		Komuna nuk kishte monitoruar mënyrën e shfrytëzimit të subvencioneve.	
3.6 Të hyrat	Kryetari të vendosë kontrolle të brendshme shtesë në fushën e mbledhjes, barazimit dhe raportimit të të hyrave vetjake. Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzoj të gjitha burimet për verifikim të pronave.		Kryetari ka vendos kontrolle në menaxhimin e të hyrave vetjake, mirëpo sfide e mëtutjeshme mbetet verifikimi i pronave.	

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të formoj komisione për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.	Po		
3.7.2 Trajtimi i Llogarive të arkëtueshmeve	Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmerr veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.			Nuk janë marrë masa.
3.7.3 Trajtimi i Llogarive të pagueshme	Kryetari duhet të rishikoj gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me avokatin komunal, duhet të ndërmerr një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për t'iu shmangur ekzekutimeve drektë nga MF dhe gjykatat.		Detyrimet kontingjente ishin trajtuar, mirëpo mbetet sfidë raportimi i plotë i obligimeve dhe pagesa vonesat në pagesën e obligimeve.	

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2016	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale dhe prezantimin e saktë të llogarive të arkëtueshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Po		
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.		Nuk monitorohet formalisht zbatimi i rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë mbetur të pa zbatuara.	
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të siguroj se është rishikuar cilësia dhe plotësia e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Nuk janë ndërmarrë veprime për adresimin e fushave me dobësi të identifikuara në pyetësinë e vetëvlerësimit.	
2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike	Kryetari duhet të inicioj hartimin dhe të propozoj për miratim në asamblenë komunale planet strategjike për zhvillimin e komunës, duke vendosur objektiva të qarta strategjike dhe duke mbikëqyrur dhe matur realizimin e tyre.	Po		

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Ecuritë buxhetore duhet të mbikëqyren vazhdimisht për të shmangur suficitet e fundvitit si dhe për të rritur nivelin e arkëtimeve.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të Brendshëm	Kryetari të siguroj funksionimin e plotë të Komitetit të Auditimit dhe NJAB për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm.		NjAB ka arritur të realizoj planin në tërësi, mirëpo Komiteti i auditimit nuk ishte funksional gjatë vitit 2017.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar, si dhe të zvogëlojë sa më shumë obligimet e bartura për pagesë në vitin tjetër.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që gjatë planifikimit fillestar të buxhetit, të hyrat janë përfshirë sipas të gjitha llojeve dhe shumave të përafërta që priten të inkasohen, si dhe të siguroj se do të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të forcoj masat e përgjegjesisë ndaj personave që aplikojnë tarifën e ngarkesave të qytetarëve dhe të sigurohet se është duke u aplikuar në mënyrë strikte rregullorja në fuqi, me tarifa dhe gjoha komunale të sakta.	Po		

3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që qytetarët të mos ngarkohen përsëri me tatimin e paguar, si dhe të bëjë përpjekje me zyrtarët e Ministrisë së Financave për të gjetur arsyet e paraqitjes së diferencave dhe të njëjtat të eliminohen.	Po		
3.1.1 Të hyrat	Kryetari të siguroj një menaxhim efektiv të kontratave të qiradhënies dhe të vendos mekanizma efikas për realizimin e të hyrave konform kushteve të kontraktuara, përkatësisht zbatimin e afateve për arkëtimin e mjeteve nga qiraja.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore.	Po		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se me kontratë shpërblehen vetëm OE që plotësojnë kërkesat e parapara në dosje të tenderit, si dhe me rastin e ndarjes së detyrave të zyrtarëve për aktivitetet të caktuara, të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të shmangët mundësia e konfliktit të interesit.			Nuk janë marrë masa.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari të siguroj se janë respektuar kërkesat ligjore në lidhje me pagesën e subvencioneve, dhe se janë ofruar dëshmi relevante që arsyetojnë qëllimin e subvencionit.		Komuna nuk kishte monitoruar mënyrën e shfrytëzimit të subvencioneve.	
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se menaxheri i projektit zbaton të gjitha kontrollet e rregullsisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit dhe nuk pranon raporte nga organi mbikëqyrës pa datë të pranimit dhe informatat tjera të nevojshme.	Po		

3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që klasifikimi i shpenzimeve bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate të përcaktuara me planin kontabël, në mënyrë që kjo të reflektoj prezantimin e drejtë të shpenzimeve në PFV.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të siguroj që regjistrat e pasurive të jenë të plota dhe të sakta, dhe për dobësitë identifikuar gjatë inventarizimit të merren veprime konkrete për përmirësim në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurisë.	Po		
3.2.2 Te arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj se janë sqaruar diferencat ekzistuese dhe të dhënat që paraqiten në raportet financiare janë të plota dhe të sakta, si dhe përfshirë të gjitha vlerat të cilat e paraqesin gjendjen reale.	Po		
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të sigurojë se departamenti i financave do t'i evidentoj, kontrolloj, raportojë dhe paguaj të gjitha obligimet brenda afateve të përcaktuara ligjore.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër konfirmimi

Komuna e Pejës



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Gazmend Muhaxheri



Kryetar i Komunës,

Data: 08.Qershor.2018, Pejë,